

LIGJ
Nr.9997, datë 22.9.2008

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.9072, DATË 22.5.2003 “PËR SEKTORIN E
ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në nenin 46, në fund të shkronjës “c” fjalët “dhe vendos masat administrative për mospërbushjen e tyre, sipas nenit 46/1” shfuqizohen.

Neni 2

Neni 46/1 shfuqizohet.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5909, datë 8.10.2008 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi